

Arbër AVRAMI,
Administratori i Albgaz



STRATEGJIA E SHQIPËRISË

për gazin natyror dhe bashkëpunimi me Azerbajxhanin

Kriza energjitike globale, e lidhur me problematikat e arkitekturës energjitike në rrafshin ndërkombëtar por edhe e ndikuar prej zhvillimeve gjeostrategjike siç provoi të ishte edhe agresioni rus në Ukrainë, gjithmonë e më shumë po i tregon shteteve dhe aktorëve të tjerë një sfidë shumë-planëshe. Kjo sfidë kërkon më së pari një reflektim shumëpërmator në drejtim të ripërçektimit të konceptit të sigurisë, pavarësisë dhe ndërlidhjes energjitike dhe zhvillimit të

qëndrueshëm për të ardhmen. Në këtë prizëm, qeveria shqiptare ka ndërmarë një plan të mirë strukturuar e ambicioz që adreson jo vetëm nevojat emergjente të vendit por edhe ofron edhe zgjidhje sa i takon të ardhmes, objektivit për një ekonomi të qëndrueshme dhe pozicionimit tonë në arkitekturën e re energjitike të rajonit.

Në këtë kontekst sfidat energjitike dhe dhënies prioritet sektorial që buron nga nevoja për garantimin e



sigurisë dhe qëndrueshmërisë së ekonomisë së vendit brenda hartës gjeostrategjike rajonale, e kanë ripozicionuar sektorin e gazit natyror në një nga sektorët më thelbësor e kontribues përsa i takon këtij objekti që gjithnjë e më shumë po kthehet në një tërësi për sigurinë kombëtare, ku duhet theksuar edhe roli i rëndësishëm që Albgaz ka marrë në një linjë me strategjinë e sipërpërmendur.

Kjo strategji është mbështetur fuqimisht prej partnerëve tanë strategjikë dhe kompanive udhëheqëse në tregun energjitik global duke përmendur vecanërisht bashkëpunimin mes shtetit shqiptar dhe shtetit të Azerbajxhanit, si edhe në nivel të drejtpërdrejtë mes Albgaz dhe SOCAR, bashkëpunim ky që ka shënjuar një kolonë të qëndrueshme zhvillimore dhe një partneritet në dobi të interesave të përbashkëta shtetërore, ekonomike e energjitike.

Projektet konkrete që burojnë prej këtij interesi janë përkthyer në zgjidhje praktike karshi sfidave të menjëhershme që ka prodhuar kriza energjitike, si edhe kanë filluar një ritëm të shtuar përsa i takon nivelit të përgatitjes dhe angazhimit në adresimin harmonik të sfidave potenciale edhe për të ardhmen. Ekspertiza dhe gatishmëria e treguar prej shtetit azer dhe kompanive azere që njëherazi janë kthyer edhe në liderë globale në tregun energjitik ka shënjuar një komponent të çmuar përsa i përket efektshmërisë së strategjisë së zbatuar prej nesh dhe thellimit të bashkëpunimit ndërkombëtar mes partnerëve strategjike në tejkalim të krizave

energjitike dhe sfidave që ato prodhojnë për gjeostrategjinë rajonale dhe sigurinë kombëtare.

Në këtë prizëm vlen të përmendet projekti inovativ i gazifikimit të Korçës, që do sjellë përfitime shumë planëshe për qytetin dhe komunitetin vendor. Ky projekt po materializohet nëpërmjet mbështetjes dhe bashkëpunimit mes qeverisë shqiptare dhe liderit azer SOCAR që si partner strategjikë i Albgaz sjell ekspertizën dhe mbështjen e nevojshme për zbatimin e këtij projekti të parë në llojin e tij, konform standarteve më të larta ndërkombëtare. Ecuria optimale e realizimit të këtij projekti dhe optimizmi me të cilin ai është pritur prej grupeve të interesit dhe komunitetit dëshmojnë për vullnetin e qeverisë shqiptare karshi prioritetit të zgjidhjeve afatgjata që garantojnë siguri energjitike dhe zhvillim të qëndrueshëm që mëton paralelisht edhe reduktimin e ndikimit në mjedis.

Paralelisht qeveria shqiptare ka ndërmarë negociime të frytshme sa i përket furnizimit me gaz me kompaninë lider në rang global si ExxonMobil, Exxerate Energy dhe SOCAR në mënyrë që të sigurohet një sasi e dedikuar për Shqipërinë, çka do i japë hov edhe materializimit konkret të projekteve të sipërpërmendura.

Po negociohet gjithashtu edhe me Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën në mënyrë që të mundësohet një integrim më i gjerë infrastrukturor i rajonit me fokus sigurinë energjitike, temë drejt së cilës Shqipëria është e vendosur të kontribuojë jo vetëm nëpërmjet lehtësimit



të ndërlidhjes nëpërmjet TAP dhe projekteve të gazit natyror por edhe nëpërmjet kontributit me energji elektrike bazuar tek TEC i Vlorës dhe HEC i Skavicës.

Në të njëjtën kohë po punohet edhe për inkuorporimin dhe jetëzimin e projektit të IAP Ltd. nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë më Bosnje-Herzegovinën, Malin e Zi dhe Kroacinë dhe pritet caktimi i datës së

nënshkrimit që do të fillonte edhe këtë projekt tjetër me rëndësi rajonale.

Në këtë prizëm një zhvillim për tu përmendur është edhe ecuria e shpejtë drejt ndërtimit të terminalit ultramodern të lundrueshëm të LNG në portin e Vlorës që do të shërbejë si bosht i zhvillimit të konsoliduar të këtij projekti brenda një kohë intensive, ku sipas parashi-





kimeve terminali do të jetë online brenda një periudhe 2 vjeçare. Në të njëjtën kohë po punohet për studimin e fizibilitetit të rijetëzimit të TEC-it të Vlorës, si pjesë e infrastrukturës që i nevojitet transformimit të vendit në një hub-i rajonal energjitik.

Një tjetër projekt i cili po jetëzohet bazuar në sa më sipër është edhe ridizenjimi i infrastrukturës së transmetimit dhe tubacionit Fier-Vlorë, i cili nën këtë vizion të ri do të akomodojë sasinë prej 5 bcm, një rritje e konsiderueshme në krahasim me sasinë prej 1.8 bcm që ishte parashikuar. Ndërtimi i këtij segmenti me rëndësi strategjike pritet të përfundojë brenda një periudhe 2 vjeçare, duke reflektuar kështu vullnetin e qeverisë shqiptare për të përshpejtuar ritmet dhe funksionalizuar këto asete strategjike për vendin.

Ky tub i ridizenjuar sipas standarteve më të larta europiane pritet të përfshijë edhe teknologjinë e nevojshme që do e mundësonte etiketimin si Hydrogen-friendly, çka nënkupton mundësinë e përdorimit të tij për transmetim eventual të hidrogjenit në të ardhmen. Paralelisht po punohet në bashkëpunim me TAP në linjë me nënshkrimin e marrëveshjes me shtetin

shqiptar në 2021 për ndërtimin e pikës dalëse jashtë stacionit të kompresorit të TAP në Fier që do të ketë një kapacitet të zgjerueshëm dhe mundësinë e rrjedhës në dy drejtime. Ky aset do të dorëzohet shtetit shqiptar dhe do të jetë në pronësi, menaxhim dhe operim të plotë të tij, duke mundësuar një pikë interkonjeksioni midis sistemit të transportit TAP dhe infrastrukturës së ardhshme të gazit në Shqipëri.

Ky vizion i Shqipërisë si qendër energjitike rajonale gjithmonë e më shumë po materializohet siç demonstron edhe prej interesit të shtuar të partnerëve ndërkombëtarë që kanë ndërmarrë hapa konkretë për të bashkëpunuar sa i përket interesit reciprok, por edhe sa i takon objektivit për diversifikimin e burimeve të energjisë dhe uljen e varësisë prej gazit rus në rajon. Në këtë konsideratë bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Azerbajxhanit dhe mes operatorit shqiptar të gazit natyror dhe kompanive azere përveçse arritjeve të theksuara përgjatë dekadës së fundit duket se tashmë po shënon një gurkre të ri drejt një të ardhmeje bashkëpunimi edhe më të thelluar e të frtyshëm në një shumësi dimensionesh përfitimi dhe sigurie reciproke ✨